



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE
ENERGJISË**

Nr. 6979/prot.

Tiranë, më 08.06.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1787, datë 31.12.2015.

**SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SH.A
Nr.1204, Rr. “Papa Gjon Pali II-të”, Tiranë.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rr. “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1787, datë 31.12.2015, për gur gëlqeror, në objektin “Moglicë” Korçë.

Leja nr.1787, datë 31.12.2015 është dhënë mbështetur në bazën ligjore, për veprimtarinë minerare, si karrierë për qëllime publike vendore ose kombëtare, ku në pikat 1 dhe 4, të nenit 23, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku thuhet:

“1. Njësitë e qeverisjes vendore ose institucioni, i cili menaxhon projekte me rëndësi kombëtare, mund t'i propozojnë ministrit miratimin e zonave minerare - karriera, për t'u shfrytëzuar për qëllime publike vendore ose kombëtare, në sipërfaqet në pronësi të njësisë përkatëse”.....

“4. Leja e shfrytëzimit të karrierave për qëllime publike vendore ose kombëtare ka afat vlefshmërie jo më shumë se 3 vjet, me të drejtë rinovimi për një vit, sipas kërkesës së zotëruesit, e cila duhet të paraqitet, së paku, 30 ditë kalendarike përpara datës së mbarimit të lejes së mëparshme”.

Me shkresën e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) nr.4539, datë 02.05.2018, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë nr.6979, datë 02.05.2018, është dërguar Vendimi i Këshillit Teknik nr.635, datë 19.04.2018, për miratimin e projektit të mbylljes së veprimtarisë minerare të lejes të shfrytëzimit nr.1787, datë 31.12.2015, për gur gëlqeror, në objektin “Moglicë” Korçë, bazuar në kërkesën e shoqërisë tuaj, që i keni drejtuar këtij institucioni.

Kërkesa juaj është e bazuar në germën “a”, të pikës nr.2 të nenit 47, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe

mbështetur në këtë bazë ligjore AKBN-ja ka marrë vendimin, ku miraton projektin e mbylljes e për rrjedhojë revokohet leja nr.1787, datë 31.12.2015, për gur gëlqeror, në objektin "Moglicë" Korçë.

Sipas nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1787, datë 31.12.2015, për gur gëlqeror, në objektin "Moglicë" Korçë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1787, datë 31.12.2015, për gur gëlqeror, në objektin "Moglicë" Korçë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitetet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO



Adresa: Bulevardi "Abdi Toptani", Nr.1, Tiranë, Faqja e Web: <http://www.infrastruktura.gov.al>